

2019-2020

MICS në Republikën e Kosovës
dhe

MICS me komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Republikën e Kosovës

Funksionimi i fëmijëve


MICS

Anketa e Treguesve
të Shumëfishtë




Funksionimi i fëmijëve: Nivelet

Nivelet e funksionimit të fëmijëve sipas grupmoshës



Përqindja e fëmijëve të moshës 2-17 vjeç me vështirësi funksionale, sipas grupmoshës

Komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë



Përqindja e fëmijëve të moshës 2-17 vjeç me vështirësi funksionale, sipas grupmoshës

Fëmijët me aftësi të kufizuara janë ndër grupet më të marginalizuara në shoqëri. Duke u përballur me diskriminimin e përditshëm në formën e qëndrimeve negative dhe mungesën e politikave dhe legjisllacionit adekuat, ata shpesh kanë gjasa të jenë ndër pjesëtarët më të varfër të popullsisë dhe kanë më pak gjasa të vijnë shkollën, të kenë qasje në shërbimet mjekësore ose t'u dëgjohe zëri në shoqëri. Diskriminimi dhe përjashtimi i fëmijëve me aftësi të kufizuara gjithashtu i vë ata në një rrezik më të lartë të abuzimit fizik dhe emocional ose formave të tjera të neglizhimit, dhunës dhe shfrytëzimit.

Konventa për të Drejtat e Fëmijëve (UNICEF, 1989) dhe Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (KB, 2006) deklarojnë në mënyrë të qartë të drejtat e fëmijëve me aftësi të kufizuara në baza të barabarta me fëmijët e tjerë dhe bëjnë thirrje për përmirësime në qasjen e tyre në shërbime, dhe në pjesëmarrjen e tyre në të gjitha aspektet e jetës.

Për t'i arritur këto qëllime, ekziston nevoja për të dhëna të besueshme dhe të krahasueshme ndërkombëtarisht. Moduli i Funksionimit të Fëmijëve është krijuar në përputhje me Klasifikimin Ndërkombëtar të OBSH-së për Funksionimin, Aftësinë e Kufizuar dhe Shëndetin dhe Konventën e OKB-së për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, për të mbledhur informacion mbi vështirësitë funksionale që fëmijët përjetojnë në fusha të ndryshme duke përfshirë dëgjimin, shikimin, komunikimin/të kuptuarit, të mësuarit, lëvizshmërinë dhe emocionet. Fëmijët me vështirësi funksionale mund të rrezikojnë të përjetojnë pjesëmarrje të kufizuar në një mjedis jo-akomodues dhe të kufizojnë përmbushjen e të drejtave të tyre.

Funksionimi i fëmijëve: Fushat

Kosovë

	Të pamurit	Të dëgjuarit	Të ecurit	Të motorikës së përsosur	Të komunikuarit	Të mësuarit	Të luajturit	Kontrollimi i sjelljes	Kujdesi për veten	Të mbajturit mend	Përqendrimi	Pranimi i ndryshimeve	Bërja e miqve	Ankthi	Depresioni
2-4 vjeç	<1	0	<1	<1	2	<1	<1	1	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A
5-17 vjeç	<1	<1	<1	N/A	<1	<1	N/A	<1	<1	<1	<1	2	<1	5	2

Përqindja e fëmijëve të moshës 2-4 dhe 5-17 vjeçare me vështirësi funksionale në të paktën një fushë, sipas fushës së vështirësisë
N/A- Nuk aplikohet

Komuniteti Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë


	Të pamurit	Të dëgjuarit	Të ecurit	Të motorikës së përsosur	Të komunikuarit	Të mësuarit	Të luajturit	Kontrollimi i sjelljes	Kujdesi për veten	Të mbajturit mend	Përqendrimi	Pranimi i ndryshimeve	Bërja e miqve	Ankthi	Depresioni
2-4 vjeç	<1	<1	<1	0	3	1	0	<1	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A
5-17 vjeç	<1	<1	3	N/A	2	1	N/A	3	<1	2	<1	2	2	6	4

Përqindja e fëmijëve të moshës 2-4 dhe 5-17 vjeçare me vështirësi funksionale në të paktën një fushë, sipas fushës së vështirësisë
N/A- Nuk aplikohet


Mesazhet kryesore

- 8 për qind e fëmijëve të moshës 2-17 vjeçare në Kosovë u raportua se kishin vështirësi funksionale në të paktën një fushë. Një përqindje më e lartë u raportua në mesin e fëmijëve të kësaj moshe që jetojnë në komunitetet rom, ashkali dhe egjiptia (14 për qind).
- Midis fëmijëve të moshës 2-4 vjeçare, 2 për qind e atyre nga popullata e përgjithshme dhe 3 për qind tek fëmijët që jetojnë në komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian u raportua se kishin vështirësi funksionale në fushën e komunikimit.
- Ankthi u raportua si sfera kryesore e vështirësisë funksionale tek fëmijët e moshës 5-17 vjeçare: 5 për qind ndërmjet fëmijëve në popullatën e përgjithshme dhe 6 për qind ndërmjet fëmijëve që jetojnë në komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian.
- 4 për qind e fëmijëve të moshës 5-17 vjeçare nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian u raportua se kishin vështirësi funksionale në fushën e depresionit.
- Ekzistojnë pabarazi të vogla në prevalencën e vështirësive funksionale tek fëmijët e moshës 2-17 vjeçare sipas pasurisë së ekonomisë familjare dhe arsimimit të nënës në popullatën e përgjithshme: 12 për qind e fëmijëve të moshës 2-17 vjeçare në Kosovë që jetojnë në ekonomi familjare më të varfra dhe nënat e të cilëve nuk janë të arsimuara u raportua se kishin vështirësi funksionale në të paktën një fushë, krahasuar me 5 për qind të atyre që jetonin në ekonomi familjare më të pasura dhe fëmijë nënat e të cilëve ishin të arsimuara.
- Hendeku sipas pasurisë së ekonomisë familjare është më i gjerë tek fëmijët e moshës 2-17 vjeçare që jetojnë në komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian, ku 16 për qind e fëmijëve në ekonomitë familjare më të varfra kanë vështirësi funksionale në të paktën një fushë, krahasuar me 6 për qind të atyre që jetojnë në ekonomi familjare më të pasura.

Funksionimi i fëmijëve: Pabarazitë



Përqindja e fëmijëve të moshës 2–17 vjeçare me vështirësi funksionale, sipas karakteristikave të përgjithshme



Përqindja e fëmijëve të moshës 2–17 vjeçare me vështirësi funksionale, sipas karakteristikave të përgjithshme

(R) Indeksi i pasurisë është ndërtuar duke përdorur informacionin mbi asetet e ekonomive familjare me supozimin se kjo reflekton pasurinë afatgjatë, duke i renditur ekonomitë familjare sipas pasurisë, nga më të varfërat te ato më të pasurat. Llogaritjet janë kryer veçmas në mostrën për MICS për Kosovë dhe mostrën për MICS me komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian në Kosovë, duke përdorur karakteristikat për secilën mostër përkatëse. Rezultatet e llogaritura të pasurisë pra janë të zbatueshme vetëm për të dhënat e veçanta në të cilat bazohen dhe ndryshojnë për dy anketat. Gjetjet sipas rezultateve të pasurisë të llogaritura për MICS me Komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian tregohen me '(R)' në grafikon.

Anketa e Treguesve të Shumëfishtë për Kosovë (MICS) dhe MICS me komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë janë realizuar në 2019-2020 nga Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) si pjesë e programit global MICS. Mbështetja teknike u sigurua nga Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët (UNICEF), me fonde të siguruar nga Ministria e Financave (MF), Qeveria e Luksemburgut, Fondacioni i Mijëvjeçarit

në Kosovë (MFK), UNICEF, Ekipi i Kombeve të Bashkuara të Kosovës (UNKT), Fondi i Popullsisë i Kombeve të Bashkuara (UNFPA) UN Women. Qëllimi i kësaj pasqyre të shkurtër informative është shpërndarja e gjetjeve të zgjedhura nga MICS 2019-2020 në Kosovë dhe MICS 2019-2020 me komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë lidhur me funksionimin e fëmijëve. Të dhënat nga kjo pasqyrë e shkurtër informative mund të gjenden

në tabelat EQ.1.1, EQ.1.2, EQ.1.3 dhe EQ.1.4 në Raportin e Gjetjeve të Anketës (treguar me shkronjën 'R' për MICS me komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë).

Pasqyrat tjera të shkurtra informative statistikore dhe Raporti i Gjetjeve të Anketës për këtë anketë dhe anketa të tjera janë në dispozicion në mics.unicef.org/surveys.